






**KONGRESI I**  
**MANASTIRIT**

Manastir, 2018.



Me zgjidhjen e çështjes së njësimimit të alfabetit të gjuhës shqipe, Kongresi i Manastirit i vitit 1908 mbylli një epokë të tërë në historinë e kulturës shqiptare, kurorëzoi me sukses përpjekjet, që mendjet më të ndritura të kombit shqiptarë bënë gjatë shekujve për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit grafik të saj, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e të përshtatshëm për gjuhën shqipe dhe të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, ashtu sikurse edhe vetë populli shqiptarë është një nga popujt më të vjetër të këtij gadishulli. Ashtu si dy gjuhë të tjera indoevropiane, rumanishtja dhe lituanishtja, gjuha shqipe ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Libri i parë shqip që njohim deri sot është “Meshari” i Gjon Byzikut i vitit 1555.



“Meshari” i Gjon Byzikut – vitit 1555

Fakte të ndryshme dëshmojnë se shqipja duhet të jetë shkruar qysh mjaft kohë para Byzikut. Këtu nuk është fjalë vetëm për dokumentet e njohura si “Formula e pagëzimit” ( 1462 ) e Pal Engjëllit, “Fjalorthi i Arnold Fon Harrfit”, “Perikopeja e Ungjillit” e ndonjë tjetër dëshimi e shkurtër shqip, por për një traditë shkrimi.



## Përgatitja e Kongresit

Përhapja e shkollave dhe e shkrimit shqip, si dhe sukseset që arritën patriotët shqiptarë në luftën për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptarë, bënë edhe më të ngutshme nevojën e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe.

Nismën për thirrjen e kongresit kombëtar për vendosjen e një alfabeti të vetëm e mori klubi shqiptarë "Bashkimi" i Manastirit, që luante rolin kryesor midis klubeve shqiptare. Qysh në ditët e para pas shpalljes së kushtetutës nga ana e Xhonturqëve, patriotët shqiptarë, e në mënyrë të veçantë drejtuesit e klubit "Bashkimi" të Manastirit, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte çështja e alfabetit të vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare në Shqipëri, e shpallën atë si detyrën e tyre më të ngutshme.

Në 27 gusht të vitit 1908, pas vendimit që kishte marrë që në 21 gusht, kryesia e klubit "Bashkimi" të Manastirit, shpalli Zëdhënien (thirrjen) e saj, me të cilën u bëri të ditur gjithë klubeve dhe shoqërive brenda dhe jashtë Shqipërisë propozimin për mbledhjen e kongresit të alfabetit në 14 nëntor të vitit 1908, në të cilin do të ftoheshin të gjithë shqiptarët, gegë e toskë, si dhe të jashtëmit e çdo filolog, që interesohej për këtë çështje, për të marrë pjesë në këtë kongres të madh.



## Çështja e alfabetit dhe vendimi i Kongresit për zgjidhjen e saj

Si rezultat i punës së madhe përgatitore dhe organizative, që zhvilloi klubi i Manastirit dhe klubet dhe shoqëritë të tjera shqiptare, në 14 nëntor të vitit 1908 u mblodh në Manastir, në ndërtesën ku ishte vendos selia e klubit "Bashkimi", Kongresi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, që i vazhdoi punimet e tij deri në 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut. Meqë çdo klub ose shoqëri kishte të drejtë të dërgonte në Kongres 2 delegatë, 32 delegatë kishin 52 vota (disa prej tyre kishin nga dy vota).

Përveç këtyre, në Kongres morën pjesë gjithashtu edhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Në këtë mënyrë Kongresi i Manastirit u shëndrrua në kuvend mbarëshqiptar, ku morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjithë anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës, si dhe nga shoqëritë shqiptare të Sofjes, të Bukureshtit, të Konstancës, të Amerikës, të Egjiptit, të Italisë etj.



*Delegatët të Kongresit të Manastirit*

Tridhjetë e dy delegatët me të drejtë vote ishin shkrimtarë e publicist të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laik e klerikë, veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare si : Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Ndre Mjeda, Gjergj K. Qiriazi, Bajram F. Topulli, Nuzhet Vrioni, Grigor M. Cilka, Nikollë Kaçorri, Fehim



Zavalani, Dhimitër Mole, Rrok Berisha, Thoma Avrami, Hilë Mosi, Akil Eftimiu, Adham Shkaba, Mati Llogoreci, Azis Beu (Shkodër), Shefqet Frashëri, Simon Shuteriqi, Leonidha Naço, Zejnel Glina, Sami Pojani, Refik Toptani, Mihail Grameno, Hafiz Ibrahim efendiu (Shkup), Rauf Beu (Gjirokastër), Selahedin Beu (Manastir).

Megjithëse klubet dhe shoqëritë shqiptare u përfaqësuan gjerësisht në Kongres, ai nuk arriti të tërhiqte të gjithë intelektualët më të përgatitur në çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Sipas Gjergj Qiriazit, nënkryetar i klubit "Bashkimi" të Manastirit dhe i Kongresit dhe anëtar i Komisionit të alfabetit, "shumica e njerëzve të ditur të Shqipërisë, që dëgjuan për këtë Kongres, mendonin se nuk ishte koha për një gjë të këtillë" ... Pati edhe nga që sipas Gjergj Qiriazit, në Kongres kishte edhe të tillë që erdhën vetëm për të qenë të pranishëm, pa pritur ndonji përfundim të mirë". Por Gj. Qiriazit shkruante, se rezultatet e mira të Kongresit provuan se ata që mendonin ashtu kanë qenë në gabim, se rruga që zgjodhën intelektualët e shquar për zgjidhjen e problemit të alfabetit duke thirrur një kuvend kombëtar, ishte më e drejta. Vepra e kryer në Kongresin e Manastirit i qëndroi kohës, u bë pjesë e pandarë e kulturës shpirtërore të kombit shqiptar. Kjo u bë e mundur sepse të gjithë patriotët të mbledhur në Manastir ishin të vetëdijshëm se kishin marrë përsipër të zgjidhnin një nga detyrat më të mëdha dhe më shqetësuese të kohës për kombin shqiptar. Pa një vetëdijshmëri të tillë mund të kuptohet vendosmëria e tyre për të mos u larguar nga Manastiri të përçarë, pa e zgjidhur përfundimisht këtë çështje sa të vështirë aq edhe të rëndësishme. E vendosmëria për të gjetur një gjuhë të përbashkët për njësimin e alfabetit, nuk duhet kuptuar vetëm si pasojë e trysnisë në rritje, që po ushtronin qarqet e ndryshme atdhetare brenda dhe jashtë vendit por në radhë të parë si fryt i bindjes së tyre të palëkundër se zgjidhja e këtij problemi ishte bërë tepër e ngutshme dhe nuk priste më. Përdorimi i disa alfabetvetë të ndryshëm për shkrimin e gjuhës shqipe po rrezikonte ta thellonte më tej përçarjen midis shqiptarëve në një kohë kur ata kishin nevojë më shumë se kurrë për bashkim në përpjekjet e tyre për të hequr qafe sundimin shumëshekullor osman. Përpjekja e të gjithë delegatëve të Kongresit të Manastirit për tu ngritur mbi pikëpamjet e ngushta vetjake në të mirë të kërkimit të një zgjidhjeje të pranueshme nga të gjithë, është edhe mesazhi më kuptimplotë, që na ka përcjellë Kongresi i Manastirit i vitit 1908. Seancën e hapjes së punimeve të Kongresit e drejtuan si kryetar të saj Rexhep Hoxha (Efendiu), dhe Fehim bej Zavalani kryetar i klubit "Bashkimi" të Manastirit. Në këtë seancë ishin të pranishëm si të ftuar valiu i vilajetit të



Manastirit Hivzi Pasha, që u zgjodh edhe kryetar nderi i Kongresit, oficerë të lartë si dhe mjaft elementë të kombësive të tjera, grekë, bullgarë e vlllehë. Mbledhjet e ditës së parë dhe të dytë u zhvilluan të hapura, në to morrën pjesë rreth 400 veta. Në seancën e pasditës u zgjodh kryesia që do të udhëhiqte dhe drejtonte punimet e Kongresit: Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri (Lumo Skendoja), ndërsa nënkryetarë u zgjodhën Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi, sekretarë: Hilë Mosi, Thoma Avrami dhe Nyzhet bej Vrioni.

Punimet e Kongresit i hapi Fehim bej Zavalani, i cili foli për qëllimet e këtij kuvendi dhe në fund të fjalës së tij iu lut gjithë delegatëve “të cilëve kombi u kishte lënë në dorë një çështje kaq të rëndësishme”, siç ishte ajo e alfabetit, të tregonin mençuri për ta zgjidhur atë, siç priste ai në një mënyrë që të çonte në bashkimin e shqiptrëve, që kombi të jetë i lumtur si edhe kombet e tjerë. Pas tij e mori fjalën Gjergj K. Qiriazi që lexoi emrat e delegatëve të të gjitha shoqërive të vendit. U pranua gjithahtu që ai të drejtonte punimet e Kongresit deri sa të vinte kryetari, Mithat Frashëri që pritej të arrinte të nesërmen. Siç dëshmohet në dokumentet e kohës Kongresi u shëndrrua në një manifestim politik të Lëvizjes politike Shqiptare. Mbledhja e ditës së parë (e 14 nëntorit) dhe ajo e ditës së dytë (e 15 nëntorit), në të cilat kanë qenë të pranishëm përveç delegatëve dhe shumë shqiptarë të tjerë, ashtu siç ishte parashikuar, u zunë me diskutimin e përgjithshëm të problemit. Në këto mbledhje u mbajtën fjalime të shumta patriotike për bashkimin e gjithë shqiptarëve, toskë e gegë, krishterë e muslimanë, për zhvillimin e ardhshëm kulturor dhe ekonomik të Shqipërisë e nevojën e ngutshme për të gjetur një zgjedhje problemit të alfabetit dhe për rëndësinë e një alfabeti të përbashkët për bashkimin dhe pëparimin e kombit. Për qëllimin e Kongresit foli Selahedin Beu, shqiptar nga Prizreni, oficer dhe zëvënës prefekt anëtar i Xhemijetit (Partisë) xhonturk, i cili e quajti këtë një kuvend të rëndësishëm, që mblidhej një kohë me palamentin turk në Stamboll. Ai e vuri theksin gjithashtu në “dashurinë vëllazërore që ekzistonte ndërmjet shqiptarëve, krishterë e muslimanë”. Pasi folën edhe mjaftë të tjerë, sekretari, Hilë Mosi lexoi telgramet që i kishin ardhur Kongresit nga shqiptarët e Italisë, prej Bibë Dodë Pashës së Mirditës, Preng Doçit, abatit të Mirditës dhe jeziutëve të Shkodrës. Një fjalim me interes të veçantë e mbajti Ndre Mjeda, që e trajtoi çështjen e alfabetit nga pikëpamja filologjike, domethënë si një problem gjuhësor dhe letrar. Ashtu si ky dhe delegatët e tjerë që folën pas tij, i përfundonin fjalimet e tyre duke theksuar se “të gjithë duhej të sakrifikonin interesat vetiake për të arritur unitetin ndërmjet shqiptarëve për çështjen e alfabetit”. Në mbledhjet e ditës së dytë që u hapën pas një koncerti me këngë



patriotike të nxënësve të gjimnazit të Manastirit, u mbajtën përsëri fjalime të përgjithshëm për rëndësinë e alfabetit të përbashkët nga Hilë Mosi, Luigj Gurakuqi, Leonidha Naçi, Mihal Gramenoja, Refik Toptani dhe Dhimitër Buda. Të gjithë këta, pasi shprehnë mendimet për çështjen e alfabetit, i mbyllën fjalimet e tyre me thirrjen që "të gjithë duhet të sakrifikojmë interesat vetjake që të vendosim unitetin midis alfabetit të gegërishtes në veri dhe toskërishtes në jug.

Ashtu siç pritej vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit, duke filluar nga dy ditët e para e tij e zuri çështja e vendosjes së një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, çka përbënte edhe qëllimin e thirrjes së tij. Por, siç treguan diskutimet e dy ditëve të para dhe ato që u zhvilluan më pas, kjo çështje, në dukje e thjeshtë, paraqitej shumë e vështirë për tu zgjidhur, sepse pjesëmarësit e Kongresit dhe të njëmbëdhjetë anëtarët e Komsionit, që u caktuapër këtë qëllim, përfaqësonin qarqe të ndryshme dhe alfabete të ndryshme. Dhe me siguri secili prej tyre do të ketë qënë i bindur se alfabeti "i zemrës" së tij ishte pa asnjë mëdyshje më i përshtatshmi për shkrimin e gjuhës shqipe. Kështu p.sh. ata që mbronin alfabetin e Stambollit të vitit 1879, mendonin ashtu jo vetëm sepse ai alfabet ishte fryt i bashkëpunimit të disa patriotëve të shquar nga vise të ndryshme të Shqipërisë, por edhe sepse i kishte plotësuar mirë nevojat e shkrimit të shqipes gjatë botimit të një vargu veprash me vlerë, si ato të Naimit, Samiut, Vretos etj, dhe të disa teksteve mësimore për shkollat, si dhe botimi i gazetave "Drita" e Shahin Kologjës, "Liria" e Mithat Frashërit, "Kalendari Kombiar" i Sofies etj. Gjithashtu duhet pasur parasysh se ai alfabet me tridhjetë e gjashtë shkronjat e tij plotësonte më së miri kërkesat fonologjike për shkrimin e gjuhës shqipe. Mirëpo karakteri johomogjen i shkronjave të tij (kryesisht latine, por edhe greke si dhe disa shkonja të posaçme) e bënte të vështirë përdorimin e tij për të botuar libra e fletore nëpër shtypshkronja të vendeve të ndryshme. Por më tepër ky alfabet u përhap vetëm në Shqipërinë Jugore dhe Shqipërinë të Mesme, kurse në Shqipërinë Veriore, veçanërisht në Shkodër përdorreshin tri alfabetetë tjera me bazë të alfabetit latin. Alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" i bazuar në alfabetin thjesh latin dhe i plotësuar me dyshkronjësha të sajuara me shkronja latine, ishte shumë më praktik për botime librash e librezash në çdo shtypshkronjë të Evropës. Edhe përfaqësuesit e alfabetit të shoqërisë "Agimi" kishin arsye të mbronin alfabetin e tyre, sepse ai i mbështetur në parimin që një tingill të shënohej me një shkronjë të vetme, ishte shkencërisht i saktë. Por edhe ky alfabet, i mbështetur në alfabetin latin të plotësuar me shkronja diakritike,



ashtu si ai i Stambollit, paraqiste vështirësi për botimin e librave. Arsyetime të ngjashme mund të silleshin edhe për alfabetet të tjera të përdorura deri atëherë për shkrimin e gjuhës shqipe.

Por me gjithë ndryshimet e mëdha në pikëpamjet e delegatëve të Kongresit për punën të alfabetit dhe me gjithë ndërhyrjet e drjtëpërdrejta apo tërthorta të disa qarqeve të huaja, pjesëmarrësit në Kongresin e Manastirit ditën ti kapërcenin këto vështirësi, falë vendosmërisë së tyre për ti dhënë patjetër një zgjidhje këtij problemi. E kjo vendosmëri u duk qartë qysh në fjalimet e mbajtura në mbledhjet e hapura të dy ditëve të para të Kongresit nga përfaqësuesit të krahinave dhe të rrymave të ndryshme. Të gjithë ata që e morën fjalën, vunë nevojën e nguthsme për të gjetur një zgjedhje sa më të mirë e sa më të shpejtë këtij problemi. Përgjithësisht nga këto diskutime të dy ditëve të para u duk se alfabeti, që do të vendosej duhej të kishte si bazë alfabetin latin. Të gjithë folësit vunë në dukje se mbi bazen e këtij alfabeti ishin formuar të tri alfabetet më të përdorura të kohës – alfabeti i Stambollit, alfabeti i shqërisë “Bashkimi” dhe ai i shoqërisë “Agimi” të Shkodrës. Edhe shumica dërmuese e botimeve shqipe, në vende të ndryshme të botës shtypeshin me alfabetin latin. Në kushte të tilla askush nuk mund të guxonte të ngrinte zërin e të propozonte që të merrej si bazë alfabeti arab ose grek, megjithëse nuk mungoi ndonjë orvatje për tu rekomanduar shqiptarëve alfabetin grek.

Por sadoqë të gjithë u shprehën për bazën latine të alfabetit që do të vendosej, pikëpamjet e delegatëve, më tej nuk pajtoheshin. Gjithësesi, ashtu siç pritej, diskutimet u përqëndruan rreth tri alfabetet kryesore. Një propozimin që meriton të përmendet, është ai që bëri Hilë Mosi, delegat i shoqërisë “Gegëni” të Shkodrës në mbledhjen e paradrekës së ditës së dytë. Ai propozoi që të krijohet një alfabet i ri, duke bashkuar tri alfabetet më të përdorura – të Stambollit, të “Bashkimit” dhe të “Agimit”. Edhe Luigj Gurakuqi, delegat i Shkodrës dhe i arbreshëve të Italisë, propozoi që të krijohet një alfabet i ri, në mënyrë që të mos i thyhej zemra askujt.

Mjaft nga ata që moren fjalën në mbledhjen e pasdrekes së kësaj dite, si Shefqet Beu, Ndre Mjeda, L. Gurakuqi, Fehim Efendiu, Bajram Topulli, Selahedin Beu, Mihal Gramenoja dhe Ferit bej Ypi, propozuan që zgjidhja e çështjes së alfabetit ti ngarkohej një komisioni, të zgjedhur nga Kongresi. “Gjithë përgjegjësiya, thanë ata, ti ngarkohej një komisioni, anëtarët e të cilit le ti japin fund kësaj çështjeje të njësimi të alfabetit, siç është mirë për të gjithë”.

Punimet e ditës së tretë të kongresit iu kushtuan zgjedhjes së Komisionit i cili “do të ngarkohej për të vendosur çështjen e alfabetit”. Por edhe në këtë



ditë u mbajtën fjalime, nga dy delegatë, nga Nikollë Kaçori dhe Gjergj Fishta. Me interes të madh u prit fjalimi i Gjergj Fishtës, të cilën Gj. Qirijazi e quante në raportin e tij “një bisedë të shkëlqyer”. Pasi foli për punën e bërë nga shoqëria “Bashkimi”, me alfabetin e saj, Fishta u shpreh i gatshëm të pranonte alfabetin e përbashkët që të vendosej në Kongres. “unë - tha ai, nuk kam ardhur të mbroj ndonjërin nga këta alfabete, por kam ardhur të bashkohem me ju dhe të adaptoj atë alfabet, të cilën do ta vendosë Kongresi si më të dobishëm për ngritjen e popullit”. Gj. Fishta foli gjatë sidomos për humbjet që kanë pësuar shqiptarët në fushën e qytetërimit për shkak të mungesës së një alfabeti të përbashkët, si dhe për dobinë që do të ketë vetë qeveria turke nëse do të ndihmonte popullin shqiptar që të futej në rrugën e qytetërimit. Ai gjithashtu foli për gjendjen e ndërlikuar politike ndërkombëtare të Shqipërisë, që ishte e “rrethuar nga armiqë, të cilët po përpiqen të rrëmbejnë nga një copë prej territorive të saj” dhe shprehu gatishmërinë e shqiptarëve për “të mbrojtur atdheun me armë në dorë për të mos lënë që armiqtë të marrin qoftë edhe një pëllëmbë tokë shqiptare”. Duke përshkruar këto ngjarje Gj. Qiriazit se keto, dhe këshillat e tjera të Gj. Fishtës impresionuan dhe prekën aq shumë zemrat e të pranishmëve, myslimanë e krishterë, sa që nuk mundën ti mbanin lotët e tyre. Kur Fishta mbaroi bisedën dhe ishte duke zbritur nga platforma, u sul drejt tij Hafëz Ibrahim efendi nga Shkupi, e përqafoi me sytë e mbushur me lotë dhe e puthi. Kjo skenë që u zhvillua në praninë e 300 - 400 vetave, shumica e të cilave ishin myslimanë, la një përshtypje të madhe mbi gjithë këta.

Ne seancën e kësaj dite të tretë (në 16 nëntor), që ishte e rezervuar vetëm për delegatët e Kongresit, u vendos përfundimisht që të zgjidhej një komision prej 11 vetësh, ku do të bënin pjesë përfaqësues të alfabeve të Stambollit, të “Bashkimit” dhe të “Agimit” dhe publicistë e intelektualë të njohur. Këtij komisioni që u zgjodh po atë pasditë me vota të fsheshta, iu dhanë fuqi të plota për të vendosur një alfabet, të cilin të gjithë delegatët e Kongresit u zotuan se do ta pranonin detyrimisht si një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Komisioni përbëhej nga Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mithat bej Frashëri, Shahin bej Kolonja, Dhimitër Buda, Dom Ndre Mjeda, Gjergj K. Qiriazit, Bajram Fehmi Topulli, Nyzhet Vrioni dhe Gligor M. Cilka. Në fund të kësaj mbledhjeje u vendos që komisioni i alfabetit të fillonte nga puna që të nesërmen, në 17 nëntor.

Duke qenë se Gjergj Fishta mori numrin më të madh të votave në krahasim me anëtarët e tjerë, ai u caktua edhe kryetar i komisionit. Gjergj Fishta atëherë ishte tridhjetë e shtatë vjeç, pra nuk ishte as më i moshuari



dhe as më i përgatituri nga ana filologjike, por ishte një poet me emër, që i mallëngjeu të gjithë në një mbledhje të hapur të Kongresit me fjalën e tij prekëse dhe me vendosmërinë e tij për ti gjetur patjetër një zgjidhje problemit të alfabetit. Zgjedhja e Gjergj Fishtës në këtë rast ka qënë pa dyshim me rëndësi për mbarëvajtjen e punimeve të Komisionit të të Njëmbëdhjetëve.

Për mbledhjet me dyer të mbyllura, që bëri Komisioni i të Njëmbëdhjetëve gjatë tri ditëve (17 - 19 nëntor 1908), na mungojnë të dhëna të plota dhe të qarta. Kemi vetëm një raport (me datë 20 janar 1909), të shkruar nga Gjergj Qiriazit, një nga njëmbëdhjetë anëtarët e komisionit, si dhe disa shënime të karakterit të procesverbalëve për mbledhjen e datës 20. XI. 1908 (2 faqe) dhe për mbledhjen e fundit të datës 22.XI.1908 (4 faqe); këto ruhen në Arkivin e Shtetit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu në të njëjtin Arkiv (Fondi Themistokli Gërmenji) ka disa shënime për mbledhjen e pestë dhe të gjashtë të datës 18.XI.1908, të shkruar në dialektin gegërisht me alfabetin e Stambollit. Sipas Mahirr Domit, ato mund të jene shkruar nga Luigj Gurakuqi. Ai vëren se në këto shënime ka edhe ndonjë mospërkim me të dhënat e relacionit të Gjergj Qiriazit (1909) për punimet e atij komisioni, del qartë se në mbledhjet e tij me dyer të mbyllura diskutimet kanë qënë të gjalla në mbrojtje të njërës apo të tjetrës zgjidhje. Por edhe pa këto të dhëna të Gjergj Qiriazit mund të merret me mend se vështërsitë, që ishin për të kapërcyer për zgjedhjen e një alfabeti të vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe, do të ishin të mëdha, duke qënë se në atë komision bënë pjesë anëtarë, që ishin për alfabetin e Stambollit, si dhe anëtarë që mbronin alfabetin e "Bashkimit" dhe atë të "Agimit". Është e vërtetë se të tri këto alfabete mbështeteshin në alfabetin latin, por ndryshonin në mënyrën e plotësimit të shkronjave, që i mungonin atij alfabeti; madje, ndryshonin edhe në vlerat fonetike, me të cilat i kishin përdorur disa shkronja latine. Dhe siç ndodh shpesh në raste të tilla, ajo që i dallon njerëzit e mbluon atë që i bashkon. Por në Komisionin e Njëmbëdhjetëve nuk ndodhi kështu, megjithëse ishte e natyrshme që sicili nga anëtarët e tij të mbronin pikëpamjet e veta.

Sipas raportit të Gjergj Qiriazit, anëtarët e Komisionit, pasi lidhën besën se do të mbanin në fshehtësi atë që do të bisedonin, derisa të vendosej puna e alfabetit, diskutuan gjerë e gjatë mbi këto tri pika:

1. A do të adaptohet njëri nga tri alfabetet kryesore, d.m.th. alfabeti i "Bashkimit" apo ai i "Agimit"?
2. A të bëhet një kombinim i këtyre tri alfabeteve?



### 3. A të lihen mënjane të tria këto alfabetet dhe të krijohet një alfabet krejt i ri?

Pas shumë diskutimesh Komisioni më parë vendosi që të mos i mari parasysh asnjërin nga tri alfabetet të lartë përmendura, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e alfabetit latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me kërkesat e gjuhës shqipe. Të gjitha shkronjat latine u shqurtuan me kujdes dhe u pranuan, duke bërë ndryshime në vlerën fonetike të disa shkronjave. Po autori i raportit nuk jep ndonjë sqarim për këto ndryshime. Mirëpo lidhur me shkronjat e nevojshme për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes, si : dh, gj, ll, nj, sh, th etj.

Komisioni nuk mundi të binte në ujdi. Sipas Gjergj Qiriazit, vetëm për shkronjën, me të cilën do të pasqyrohej tingull ndërthëmbor /dh/, diskutimet zunë dy mbledhje të tëra, pa arritur ndonjë përfundim të kënaqshëm. Qiriazit nuk jep ndonjë sqarim lidhur me mendimet e ndryshme të shprehura për këto shkronja dhe për shkronjat e tjera të diskutuara. Por duke marrë parasysh pikëpamjet e përgjithshme të anëtarëve të Komisionit, nuk është vështirë të nxirret përfundimi që në këtë rast mendimet, në vija të përgjithshme, duhet të jenë ndarë dysh. Ata që përfaqësonin alfabetin e Stambollit dhe atë të "Agimit" duhet të kenë mbrojtur parimin që të mos kishte shkronja dyshe (dyshkronjështa), kurse ata që përfaqësonin alfabetin e "Bashkimit", duhet të kenë ngulur këmbë në të kundërtën, d.m.th. që alfabeti latin të plotësohej me dyshkronjështa.

Duke parë se ishte e pamundur që të binin në ujdi për shkronjat e diskutueshme dhe "të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme", anëtarët e komisionit vendosën që "të kthehen prapa", duke pranuar alfabetin e Stambollit, "e me të bashke një abecë fjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mes të shqiptarëve". Pra arsyet për të cilat komisioni u detyrua të hiqte dorë nga krijimi i një alfabeti krejt të ri mbi bazën e alfabetit latin, kanë qenë dy:

1. Vështirësitë e mëdha për të kapërcyer divergjencat lidhur me karakterin e shkronjave, me të cilat do të pasqyroheshin tingujt e tillë, si / dh, gj, ll, nj, sh, th / etj.

2. Disa shkaqe të jashtme.

Në vendimin e Komisionit të Alfabetit nuk jepet ndonjë sqarim se ç'ishin këto shkaqe të jashtme. Kur u shpall ky vendim në mbledhjen e hapur të Kongresit në 20 nëntor para drekës, u tha se alfabeti i Stambollit ishte i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e kombit, porse, që të mund të



shtypeshin libra jashtë Shqipërisë si dhe për telegrame jashtë vendit, nevojitej edhe një alfabet tjetër thjesht latin. Pra, arsyeja e adoptimit të një alfabeti të dytë thjesht latin, në mbledhjen e hapur të Kongresit u paraqit si një çështje thjesht teknike. Por sipas raportit të Gjergj Qiriazit “Përse u zgjodhën dy alfabete”, ky vendim arsyetohet ndryshe. Aty thuhet: “Telegramet që morëm nga Gegëria, na kërkonin që të prananim alfabetin e “Bashkimit”, kurse telegramet nga Toskëria na kërkonin që të mernim atë të Stambollit ose të Frashërit. Komitetit [kupto: komisionit] iu desh t’i merrte parasysh të gjitha këto letra e telegrame, sepse, po të injoronte njërin apo tjetrin palë, do të ishte një pengesë e madhe në përparimin e kombit dhe, meqë këto dy alfabete përdorshin nëpër shkolla, njëri në Gegëri dhe tjetri në Toskëri, ne vendosëm unanimisht të adaptojmë dy alfabete, atë të “Bashkimit” dhe atë të Frashërit, me disa ndryshime, sipas nevojave të gjuhës”.

Gjithsesi, po të shqyrtohen me vëmendje përfundimet e Komisionit të Njëmbëdhjetëve, atëherë nuk është vështirë të kuptohet se arsyeja kryesore për të caktuar edhe një alfabet të dytë thjesht latin, ajo që u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit në 20 nëntor 1908, ka qenë lehtësia e shtypshkrimit me të, e jo presionet që vinin nga jashtë. Natyrisht, nëpërmjet një vendimi të tillë plotësoheshin edhe kërkesat (trysnitë nga jashtë), për të cilat bën fjalë Gjergj Qiriazit në raportin e tij. Por kjo, pas gjithë gjasash, duhet të ketë qenë pasojë e arsyes së pare dhe jo arsyeja kryesore. E në këtë përfundim arrihet edhe po të kihet parasysh se alfabeti i dytë thjesht Latin, i vendosur nga Komisioni i të Njëmbëdhjetëve, siç do të shtjellohet me poshtë, nuk është i njëjtë me atë të “Bashkimit” (që kërkohej nga Shqipëria e Veriut), siç është pandehur ose thënë nga disa.

Si një çështje thjesht teknike këtë vendim e trajton edhe Gj. Fishta, kur në fjalën që mbajti në mbledhjen e 20 nëntorit tha se “alfabeti i Stambollit është i mjaftueshëm për t’ju përgjigjur nevojave të kombit, porse që të shtypeshin libra jashtë Shqipërisë dhe për të dërguar telegrame (jashtë – shën. aut.), kemi nevojë të krijojmë një alfabet krejt me shkronja latine. Për këtë arsye Komisioni u detyrua të pranojë dy alfabete. Gjermanët edhe sot e kësaj dite bëjnë po kështu, përdorin edhe shkronjat latine edhe shkronjat gotike”.

***Komisioni vendosi që në alfabetin e Stambollit të bëheshin këto ndryshime:***

1. Shkronja /e/ dhe /ε/ të këmbeheshin midis tyre, duke përdorur shkronjën greke /ε/ për zanoren /ë/ dhe shkronjën latine /e/ për zanoren / e/, kcourse në alfabetin e vitit 1879 ishte e kundërta.



2. Shkronja /p/ të përdorej me vlerën e bashkëtingëllores /p/, kurse në alfabetin e vitit 1879 kishte vlerën e bashkëtingëllores rrotullore /rr/.
3. Bashëtingëllorja rrotullore /rr/ të shkruhej ashtu si në alfabetin e "Bashkimit", me shkronjën e dyzuar /rr/.
4. Bashkëtingëllorja afrikate /xh/ të shkruhej me shkronjën konvencionale /x/ me presje poshtë, kurse në alfabetin e vitit 1879 ajo shkruhej ndryshe /x/ (shih fotokopjen e vendimit të Kongresit me dy alfabetet).

Përsa i takon alfabetit thjesht latin, që Komisioni vendosi si alfabet të dytë për shkrimin e shqipes, qysh në fillim është përhapur mendimi se ai në thelb ishte alfabeti i "Bashkimit" e kështu e cilëson edhe Gjergj Qiriazi në raportin e tij "Përse u zgjodhën dy alfabete". Por në vendimin e Komisionit ky alfabet nuk cilësohet kështu.

Përhapja e një mendimi të tillë për alfabetin e dytë thjesht latin, që u vendos në Kongresin e Manastirit, do ta ketë burimin në faktin se ky alfabet i ngjan mjaft atij të shoqërisë "Bashkimi", me të cilën i kanë të përbashkëta shkronjat dushkronjëshe. Shoqata "Bashkimi" ka lojtur një rol të madh në zgjerimin e këtij mendimi. Por nga shqurtim i hollësishëm i kësaj çështjeje, siç është vënë në "Bashkimi", këto dy alfabete ndryshojnë midis tyre në jo më pak se 11 shkronja dhe pikërisht në shkronjat /c, ç, e, ë, gj, nj, q, x, xh, z, zh/, të cilat në alfabetin e "Bashkimit" paraqiteshin përkatësisht me /ts, ch, é, e, gh, gn, c, z, zh, x, xh/.

Nga ana tjetër, edhe sistemi i dyshkronjësive për të plotësuar shkronjat, që i mungonin alfabetit latin, nuk është një karakteristikë e posaçme e alfabetit të "Bashkimit", sepse një sistem i tillë mundet të gjinden edhe te alfabetet të tjera thjesht latine të përdorura qysh mjaft kohë përpara. Me një sistem të tillë është ndërtuar p.sh. Alfabeti i Vaso Pashës, i cili ndryshon nga alfabeti i sotëm vetëm në tetë shkronja dhe pikërisht në shkronjat /c, ç, e, ë, ll, rr, zh, x/. Edhe alfabeti thjesht latin i së gazetës "Shqipëria" të Bukureshtit (1897 – 1899), i cili ndryshon nga alfabeti i sotëm vetëm në 8 shkronja, është plotësuar, ndër të tjera edhe me dyshkronjësive. Përdorimi i dyshkronjësive, si një nga mjetet për të plotësuar alfabetin latin, gjindet edhe në botime të tjera të periodike si tek "Besa" e Kajros (1904), "Pëllasgu" i Kajros (1907) etj. Madje alfabeti i botimit periodik "Pëllasgu" është shumë më afër alfabetit të dytë thjesht latin të Kongresit të alfabetit i "Bashkimit", duke ndryshuar midis tyre vetëm në shkronjat /e, ë, gj/, që te "pëllasgu" jepen me /é, e, gh/. Prandaj, edhe nga sa u tha më lart, del e qartë se mendimi i përhapur që alfabeti i



dytë thjesht latin i Kongresit të Manastirit ishte në thelb alfabeti i shoqërisë “Bashkimi”, nuk është i mbështetur.

Po të shqyrtohen me kujdes të dy alfabetet e vendosura në Kongresin e Manastirit, nuk mund të mos bien në sy përpjekjet e bëra për t’i afruar ato sa më shumë midis tyre. Këtu nuk është fjala vetëm për tri ndryshimet e bëra në alfabetin e Stambollit, por edhe për përdorimin e disa shkronjave të përbashkëta në të dy alfabetet. Kështu në alfabetin e dytë thjesht latin të Manastirit shkronjat /c, ç, j, q, x, y, z/ u përdorën me ato vlera fonetike, që kishin edhe në alfabetin e Stambollit. E, si rrjedhim i këtyre përpjekjeve të dy alfabetet e vendosura në Kongresin e Manastirit ndryshonin midis tyre vetëm në 9 shkronja dhe pikërisht në shkronjat /dh, ë, gj, ll, nj, sh, th, xh, zh/.

Në vendimin e komisionit thuhej se të dy alfabetet do të përdroreshin “bashkarisht midis shqiptarëve” dhe shtohej : “Mësimi në shkolla do të jetë i detyrueshëm për të dyja alfabetet”.

Vendimi i komisionit të alfabetit u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit në 20 nëntor (dita e shtatë e punimeve në Kongres) para drake. Salla e mbledhjes ishte mbushur plot me shqiptarë, që prisnin me padurim të mernin vesh përfundimet e Komisionit të Alfabetit. Duke shpallur vendimin e komisionit kryetari i Kongresit Mithat Frashëri tha se “komisioni, i zgjedhur nga delegatët e Shqipërisë, e përfundoi detyrën e tij, duke u përpjekur e shpresuar për bashkim”. Pas këtyre fjalëve, Luigj Gurakuqi solli dërrasën e zezë, mbi të cilën ishin shkruar shkronjat e alfabetit“. Vendimi i Komisionit u miratua nga mbledhja me duartrokitje dhe brohoritjet: “Roftë Alfabeti!”.





*Komisioni i alfabetit*

Duke vlerësuar vendimin e Kongresit të Manastirit për çështjen e alfabetit, mund të thuhet se ai në përgjithësi dhe Komisioni i të Njëmbëdhjetëve në veçanti bënë një punë të lavdërueshme, të karakterizuar nga një ndjenjë e lartë përgjegjësie dhe nga një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi. Dhe për këtë ndihmuan të gjithë pjesëmarrësit e Kongresit dhe anëtarët e Komisionit të të Njëmbëdhjetëve e në mënyrë të veçantë Gjergj Fishta, i cili duhet të ketë ndikuar shumë edhe për krijimin e alfabetit të dytë me shkronja thjesht latine të plotësuar me dyshkronjëshe, ashtu si në alfabetin e “Bashkimit”.

Kongresi i Manastirit pra, u mbyll me një zgjedhje e cila, po të kihen parasysh kushtet politike të Shqipërisë në atë kohë, është vlerësuar me të drejtë si një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të problemit të alfabetit të shqipes.

Numri i alfabeteve që do të përdornin shqiptarët paskëta, u pakësua në dy dhe këto ngjanin midis tyre, sepse kishin si bazë alfabetin latin. Edhe më tepër, sipas vendimit të Kongresit të dy alfabetet do të përdreshin “bashkarisht”. Një gjë e tillë, jo vetëm që do të lehtësonte përhapjen e arsimit dhe diturinë në Shqipëri, sepse të paktën do t’i jepte fund kaosit të deriatëhershëm të alfabeteve, por edhe do ta forconte më tej bashkimin e popullit shqiptar pa dallim krahine dhe feje. Vendimi i Kongresit të Manastirit, pra, ndonëse përmbante një zgjidhje jo të plotë, pati një rëndësi të madhe politike për bashkimin dhe përparimin e mëtejshëm të popullit tonë.



Duke vendosur për dy alfabete, që mbështeteshin kryesisht në alfabetin latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe një herë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar. Ky aspekt i vendimit të Kongresit të Manastirit merr një rëndësi të veçantë, po të mbahet parasysh se jo shumë kohë pas Kongresit, xhonturqit e hoqën fare maskën dhe u orvatën t'u impononin shqiptarëve alfabetin arab.

Por duke vështruar me një sy kritik vendimin e Kongresit të Manastirit, nuk mund të mos arrihet në përfundimin se zgjidhja, që ai Kongres i dha problemit të alfabetit, qe një zgjidhje jo e plotë, e cila linte shteg për vazhdimin e përçarjes midis shqiptarëve. Me gjithë vendimin për ti përdorur “bashkarisht” të dy alfabetet, ishte e sigurtë se një pjesë e shqiptarëve do të përdornin alfabetin thjesht latin (sidomos në Shqipërinë Veriore), dhe një pjesë tjetër (sidomos në Shqipërinë Jugore) do të vazhdonin të përdornin alfabetin e Stambollit, duke ia lënë kështu kohës të jepte vendimin përfundimtar. Gjithsesi, ai vendim përmbante në vetvete edhe zgjidhjen e shpejtë përfundimtare të problemit të alfabetit. Dhe për këtë kemi edhe një pohim të Gjergj Qiriazit, i cili në raportin e tij shkruante: “Brenda këtyre dy vjetëve, para se të mblidhet kongresi tjetër, do të kuptohet se cili (alfabet) do të përdoret më shumë dhe ai do të adaptohet si alfabet kombëtar”. Dhe vendimi i fundit në këtë rast nuk vonoi shumë. Sidoqoftë atë që nuk e çoi dot deri në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë populli shqiptar. Alfabeti i Stambollit, duke qënë laraman, më i vështirë dhe më pak praktikë për botime librash etj. me kalimin e kohës filloi të dilte jashtë përdorimit. Kurse alfabeti i dytë, që u vendos në Kongresin e Manastirit, duke qënë më homogjen, më i lehtë dhe më praktik për botime librash etj. , erdhi e u përhap gjithnjë e më shumë, kështu që aty nga fundi i Luftës së Parë Botërore ky alfabet mbeti i gjuhës shqipe, që i plotëson fare mirë kërkesat e një gjuhë të shkruar në zhvillim të pandërprerë.

Alfabeti, që kemi sot në përdorim, ashtu si alfabeti i Stambollit, është mbështetur në parimin një shkronjë – një tingull e ky parim është zbatuar si për shkronjat e thjeshta ashtu edhe për dyshkronjëshat (ll, rr, gj, dh, sh, zh, xh). Por ai është kritikuar se në disa raste nuk e plotëson më së miri këtë kërkesë. Këtu është fjala për mosndalimin shkrimor të tinguj- shkronjave /nj/ nga /n-j/, /gj/ nga /g-j/, /dh/ nga /d-h/, /th/ nga /t-h/, /sh/ nga /s-h/ dhe /zh/ nga /z-h/, në raste të tilla si zonjë dhe qen-je, lagje dhe djeg-je, i thatë dhe Et-hem, mashë dhe mos-hapje, zhabë dhe Maz-har etj. me përjashtimim të rasteve të tipit Mit'haz, Et'hem dhe Mazhar, që janë emra të përveçëm prej burumi të huaj dhe që janë fare të paktë, ne rastet e tjera kemi të bëjmë me fjalë të prejardhura,



ku bashkimi i tingujve /n/ dhe /j/, /g/ dhe /j/, /s/ dhe /h/ ndodh në kufi të morfemave dhe për këto raste Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe ka gjetur një zgjidhje, duke këshilluar që /j/ pas /n/ dhe /g-/ të shkruhet me /-i/, si qeni, djegie etj. Vetëm për rastet e tipit mos – hapje nuk kemi ndonjë zgjidhje, por këto raste janë fare të pakta dhe nuk përbëjnë ndonjë problem. Për sa u takon emrave të përveçëm të tipit Mit'hat, Et'hem, Maz'har etj., në praktikë vihet re prirja për t'i shkruar ata thjesht Mitat, Etem, Mizar etj. Gjithsesi, këto raste nuk e vënë në pikëpyetje saktësinë e alfabetit tonë të mbështetur në parimin një shkronjë një tingull.

Në këtë rast nuk do të ishte e tepërt të kujtohet se vështirësi të tilla, madje edhe më të shumta e më të mëdha, bien në sy edhe në shkrimin e disa gjuhëve të tjera me tradita më të vjetra se shqipja, si p.sh. në gjuha anglishte, gjermanishte, italishte, frëngjishte etj., të kihet parasysh p.sh. se në gjuhët e lartëpërmenudra shkronjat /c/ dhe /g/ shqiptohen ndryshe, kur ndiqen nga një zanore e prapme ose nga një bashkëtingëllore. Të krahasohen p.sh. në italishte, nga njëra anë, cena [çena], ciclo [çiklo] etj., dhe nga ana tjetër, capo [kapo], confuse [konfuzo], culto [kulto], creare [kreare] etj., dhe gelo [xhelo], giro [xhiro] etj., përkundrajt gallo [gallo], sgombrare [zgombrare], gufo [gufo], etj. Po kështu të krahasohen në gjuhën anglishte: cell [sell], ceiling [silling], etj., përkundrajt cap [kæp], cooperate [kooperejt], create [kriejt] etj., dhe gentle [xhentll], gigantic [xhigantik], etj. përkundrajt gap [gæp], goal [go:ll] etj., por edhe give [giv], get [get] etj. Vërejtje të tilla mund të bëhen edhe për shqiptimin e disa shkronjave të tjera në ato gjuhë si edhe në gjuhë të tjera si frëngjishtja, spanjishtja etj. por këtu nuk është rasti të ndalemi më gjatë në këtë çështje. Gjithashtu vlen të përmendet se në ato gjuhë bien në sy vështirësi më të mëdha edhe në drejtshkrimin e disa fonemave, që herë jepen me dy a më shumë shkronja e herë me një shkronjë të vetme. Mjafton të përmendim këtu sa për shembull, gjermanishten ku fonema /sh/ jepet jo vetëm me treshkronjëshin /sch/, por edhe me shkronjën /s-/ nistore të ndjekur nga një bashkëtingëllore; krahaso Schiller [Shiler], Schuld [Shuld] etj., dhe Stein [shtajn], Stuttgart [Shtutgart] etj.

Siç shihet, pra, në gjuhë të tilla si gjermanishtja, anglishtja etj. nuk është ndjekur parimi një tingull - një shkronjë e si rrjedhim numri i shkronjave të alfabetit të atyre gjuhëve është më i kufizuar se numri i tingujve të tyre. Prandaj edhe nëpër fjalorët e atyre gjuhëve renditja e fjalëve është bërë në bazë të shkronjave nistore të tyre, kështu që p.sh. në gjermanishte fjalë të tilla si schuld [shuld], öffnen [ëfnen], über [yber] etj. Renditen përkatësisht te



shkronjat /s/, /o/ apo /u/ etj. kurse në fjalorët e gjuhës shqipe është zbatuar qysh në krye të herës parimi një tingull - një shkronjë edhe nëpër fjalorë e një praktikë e tillë është zbatuar edhe në gjuhët tjera ballkanike në përgjithësi (rumanisht, bullgarishte, serbokroatishte e maqedonishte).

Pasi miratoi vendimin për alfabetin, Kongresi ua kushtoi mbledhjen e pasditës së 20 nëntorit referateve me temë patriotike. Abdyl Ypi (Starja) mbajti referatin "Dobia e bashkimit të shqiptarëve ndërmjet tyre" dhe me Xhemijetin (me Komitetin "Bashkim e Përparim"), e cila siç shkruante Gj. Qiriazhi ishte mbushur me fjalë të zjarra patriotike. A. Ypi foli për fuqinë e madhe që i jep kombit bashkimi i shqiptarëve. "Bashkimi, tha ai do t'u ndihmojë shqiptarëve të zhvillohen nga ana intelektuale, morale dhe materiale, do t'i sjellë shërbime të mëdha kombit për mbarësinë e tij në rrugën e qytetërimit dhe në fusha të tjera." Dom Nikollë Kaçorri, arkipeshkopi i Durrësit dhe delegat i këtij qyteti, mbajti referatin me temë: "Detyra e çdo shqiptari është të ndihmojë materialisht për përparimin e kombi të vet". Po për këtë çështje folën atë pasdite edhe Gj. K. Qiriazhi dhe G. M. Cilka, që treguan se ndihma materiale ndaj kombit është e bekuar dhe është një nga veprimtaritë më të bukura, që lehtëson mjerimin e të tjerëve, por i shpëton jetën edhe atij që bën këtë mirësi ndaj kombit.

Në këtë ditë mbërritën në Manastir, tre delegatët e klubit "Bashkimi" të Stambollit, që priteshin prej disaditësh nga gjithë pjesëmarrësit e Kongresit, Haxhi Vildan efendi Dibra, Fazil pashë Toptani nga Tirana dhe Riza beu (Dibra), i lindur në Ohër, kolonel i Shtabit madhor osman. Dërgimi i tyre në fillim u kuptua nga trupi i huaj konsullor në Shqipëri si vepër e xhonturqve. Ky keqkuptim lindi edhe për shkak se nisja e tyre nga Stambolli u bë vetëm pas miratimit zyrtar që dhanë veziri i madh dhe qeveria turke, duke e argumentuar këtë me propagandën që ato do të bënin në Shqipëri në dobi të Kushtetutës. Edhe organizatorët dhe delegatët e Kongresit të Manastirit kujtuan në fillim se ata kanë qene të dërguar për të kundërshtuar alfabetin latin dhe për të propaganduar alfabetin arab për shkrimin e shqipes. Por shumë shpejt u mor vesh se nisma për dërgimin e këtij delegacioni në Kongres dhe për udhëtimin që ai ndërmori menjëherë pas tij nëpër qytetet e Shqipërisë, i përkiste klubit shqiptar të Stambollit dhe ishte diktuar nga motive kombëtare dhe patriotike.

Mbledhja e ditës së tetë të Kongresit (e 21 nëntorit) pati karakter të përgjithshëm dhe u shëndrrua në një miting masiv, me një pjesëmarrje më të madhe se kurdoherë më parë, siç e përshkruante atë Gj. Qiriazhi. Si salloni i madh ku zhvillohej mbledhja, ashtu edhe katër sallat e tjera të mëdha rreth tij,



shkruante Gj. Qiriazhi ish-in mbushur plot e përplot. Në një-rën nga sallat qenë vendosur 70 studentë të gjimnazit turk të Manastirit. I pari që e mori fjalën në këtë miting ishte Haxhi Vildan efendiu, kryetar i delegacionit të klubit të Stambollit. Pasi foli për rëndësinë e shpalljes së Kushtetutës, ai u përqëndrua në dy çështje, të lidhura me njëra tjetrën: në domosdoshmërinë e bashkimit të shqiptarëve dhe të çështja e alfabetit të vendosur në Kongresin e Manastirit.

Bashkimin e quajti një mjet të fuqishëm që do t'i bënte shqiptarët të aftë e të zotë për të mbrojtur veten e tyre dhe Mbretërinë Osmane. Shqipterët, theksoi ai, kanë raste të arta për të realizuar këtë bashkim. Haxhi Vildan efendiu vlerësoi në mënyrë të veçantë vendimin e përbashkët të Kongresit për alfabetin e gjuhës shqipe. Shqipëria, vijoi ai, është e lumtur, sepse tani është bashkuar me anën e alfabetit, që është një nga instrumentet më të fuqishëm e më të mirë për të përhapur përparimin në mes të popullit. Me vlerë të veçantë janë mendimet e tij për çështjen e alfabetit, për të drejtën e çdo kombi për të pasur shkronjat e tij për të shkruar gjuhën e nënës, për të zgjedhur ato shenja (alfabet) që dëshiron, që i jep mundësi të shprehë më mirë gjuhën e tij. Haxhi Vildani miratoi vendimin e Kongresit të Manastirit për alfabetin me bazë latinë, pa lënë kështu asnjë shteg për atë krah konservator xhonturk që kërkonte t'u impononte shqiptarëve alfabetin arab. Shqiptari, theksoi ai, zgjodhi latinishten me disa shtesa për gjuhën e vet. Kurse vetë turqit nuk kanë shkronjat e tyre, por përdorin ato të arabëve. Oratori nuk e quante të drejtë të përzihej çështja e alfabetit me çështjen fetare. Shkrimi, tha ai, është një instrument për lartësimin e kombit, ndërsa feja është një gjë që i përket zemrës (ndërgjegjes) dhe secili është i lirë të ketë pikëpamjet e veta. Por edhe në çështjen e besimit ai shfaqti tolerancë fetare. Le të mos harrojmë, theksoi ai, se të gjithë jemi bij të Adamit, kemi një prind dhe një atdhe. Këto fjalë, siç theksoi Gj. Qiriazhi në relacionin e tij bënë përshtypje të madhe sidomos në mendjet e shumë shqiptarëve myslimanë, që për shkak të fanatizmin, kujtonin se nuk është mirë që ata të përdorin shkronjat (latine) që përdorin krishterët dhe se nuk bënte t'i konsideronin krishterët vëllezër të tyre.

Kontributi i këtij delegacioni nuk u kufizua vetëm me fjalimet që u mbajtën në këtë mbledhje të Kongresit. Ai zhvilloi një veprimtari të gjerë patriotike edhe jashtë dyerve të Kongresit, nëpërmejt një udhëtimi që ndërmoi në qytetet e ndryshme të Shqipërisë.

Në këtë mbledhje gjithashtu folën edhe Gjergj Fishta, Abdyl Ypi e Nikollë Kaçorri. Fishta duke vënë në dukje shërbimet që shqiptarët i kishin bërë Perandorisë Osmane, kërkoi nga qeveria turke dhe nga gjithë personalitetet



zyrtare që asistonin në këtë seancë të Kongresit, të ndihmonin në çdo mënyrë për “mbarësinë e qëllimeve të shenjta kombëtare të shqiptarëve”. Sa më shumë të zgjohet e të ngrihet kombi shqiptar, tha Fishta, aq më tepër do të fuqizohet nga ana materiale e mendore.”

Kongresi u dha fund punimeve të tij me mbledhjen e ditës së nëntë (në 22 nëntor), që u mbajt me dyer të mbyllura, vetëm me pjesëmarrjen e delegatëve dhe iu kushtua çështjeve organizative. Në këtë mbledhje delegatët miratuan unanimitisht dy rezoluta që kishin të bënin me çështjet organizative të lëvizjes kulturore – kombëtare. Në rezolutën e parë thuhej se të gjithë klubet dhe shoqëritë që ekzistonin në shqipëri, duhej t’i dërgonin çdo muaj nga një raport klubit shqiptar të Manastirit, i cili nga ana e tij do t’u dërgonte atyre një raport të përgjithshëm. Me këtë vendim Kongresi e njohu si klub qendror e drejtues të të gjitha klubeve shqiptare atë të Manastirit, i cili edhe me veprimtarinë kulturore – kombëtare që kishte zhvilluar deri në atë kohë ishte afirmuar tashme si i tillë. Ky vendim, i cili siç informonte në Vienë konsulli austrik në Manastir, posfai, të nesërmen, pas përfundimit të punimeve të Kongresit, u morë pas një debati të gjatë mes delegatëve, shënoi dështimin e përpjekjeve të xhonturqve për të caktuar si qendër drejtuese të klubeve dhe të shoqërive shqiptare klubin e Stambollit, të cilin krerët e “Bashkimit e Përparimit” mendonin se mund ta kishin më lehtë ta vinin nën kontrollin e tyre. Në rezolutën e dytë thuhej që pas dy vjetesh (në 10 korrik 1910) do të mbahej në Janinë një Kongres tjetër për çështjen e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Mendim për mbajtjen e një kongresi të tillë ishte shprehur edhe në vendimin e komisionit të alfabetit. Duke e veshur klubin “Bashkimi” të Manastirit me atributet e një klubi qendror e udhëheqës për të gjitha klubet dhe shoqëritë e tjera patriotike, Kongresi ndihmoi që shkalla e organizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të ngrihej në një nivel më të lartë, në krahasim me periudhën e mëparshme.

Në mbrëmjen e fundit të Kongresit delegatët dhanë një darkë për udhëheqsit e klubit të Manastirit dhe për shqiptarët që ndodheshin aty, dhe në këtë tryezë u rrëfye gaz’i i një mbledhjeje të tillë kombëtare, mbledhje që ishte çapi i parë që bënte kombi shqiptarë drejtë bashkimit të qytetërisë, dhe u bë lutje që, si që ishin të mbledhur dhe të bashkuar në këtë salë, ashtu dhe gjithënjë të kenë mendjet dhe zemrat të bashkuara për të punuar për të mirën e mëmëdheut.



Kështu u sos Kongresi i Manastirit dhe kështu u ndanë shqiptarët, duke mbajtur në zemër të tyre një kujtim të paharruar nga këto dhjetë ditë të shkuara me një festë që se kishin parë kurrë gjer më sot.

Manastir, 1-20 vjetër e mëtej 1908.

Vendimi i Komisionit mbi shkrimin e Abecës:

Pasi që u kërkuan verbalisht o ditore t'jira o pas qe e pas me se fuqia që kishim burrë ishte njëjtë e madhe, po jo nga se të na kenagte të fideve e t'i bërante si përparimit të fjalës si të përhapimit të ditoreve ndër ne; të blye edhe nga dita shkaktuar të pyetjeve, a-kujtore propoza o me fjalë të të fideve u-vendos që të mirat Abëja e Stambolit e me të baste edhe që Abëca fjet latine që të merrhen e të përdoren bashkërisht në mes të Egypeteve eot. Mirëmi nde shpësi do të jete i bërëguar e i detyrues, në të dyja. Shkëlqime janë këto:

1) a, b, c, ç, d, ð, Ë, Ë, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, Pp, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, zh, zj.

2) a, b, c, ç, d, dh, E, E, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, Pp, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, zh, zh.

U-destina e dësirë e Komisionit e fjalëve burime, që pas dy vjetësh të rmbahet për t'përdorur e kurrë t'a vendosje Kongresit s'atohet për ortografi e literaturë të fjalës t'pyje.

Solin. 2. s Përij D. Minin M. Minin G. Minin  
 P. Minin N. Minin B. Minin C. Minin  
 D. Minin E. Minin F. Minin G. Minin

Vendimin e Komisionit e fjalëve të fide 22. delegetë, të cilët po e nëvostkujtore d'kë sine burim se kanë pre t'a mbajtës.

D. N. Malaj, Sami Sojani, D. N. Malaj, S. Suterriqi, G. Minin, Gramnos, P. Minin, M. Minin

Suleiman, Ç. Minin, D. Minin, G. Minin, H. Minin, I. Minin, J. Minin, K. Minin, L. Minin, M. Minin, N. Minin, O. Minin, P. Minin, Q. Minin, R. Minin, S. Minin, T. Minin, U. Minin, V. Minin, X. Minin, Y. Minin, Z. Minin

Salahudin





*Sevasti Dako Qiriazhi (1871-1949)*



*Parashqevi Qirijazi (1880-1970)*